



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “Alba Konstruksion” shpk**  
**Adresa: Rr. Frederik Shiroka, pallati I i ri, shkalla C, Tiranë.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur” “Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja”).

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja”).

**Fondi limit:** **45,302,909** (dyzetë e pesë milion e treqind e dy mijë e nëntëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion me VKB Nr. 49, datë 31.05.2017 për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.84, datë 29.12.2016 ”Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017, (i ndryshuar), dhe me Vendimin Nr. 12, datë 21.03.2017 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për “Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, Thirrja I për vitin 2017, të Grantit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, Programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, Shtylla I.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** **07.08.2017, ora 10:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 28 datë 17.07.2017.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk**  
**NUIS J66902042Q NUIS L47022001J**

Vlera e ofertës = **30,346,820** (tridhjetë milion e treqind e dyzetë e gjashtë mijë e tetëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

- 2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Eprofat V-50” shpk & “Bahas” shpk;**

Vlera e ofertës = **37,176,182** (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk**

NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = **39,845,920** (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

**4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk**

NUIS J61812013R

Vlera e ofertës = **44,466,240** (dyzetë e katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk**

NUIS L47022001J NUIS J66902042Q

- Operatori ekonomik “SMO Union” shpk nuk plotëson pikën dh. të kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”*, pasi ka paraqitur një vërtetim pa përfshirë pagesën e faturës së maturuar për muajin Qershor 2017.
- Operatori ekonomik “SMO Vataksi” shpk nuk plotëson pikën dh. të kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”*, pasi ka paraqitur një vërtetim pa përfshirë pagesën e faturës së maturuar për muajin Qershor 2017.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm .Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm”*, pasi secili prej operatorëve të bashkimit ekonomik nuk ka paraqitur një kontratë pune me një mjek por kontratë me një klinikë mjekësore, ndryshe nga cka kërkohet në kriterin e sipërcituar.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha*

*punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë: 1(një) inxhinier Ndërtimi, 1(një) inxhinier Elektrik, 1(një) inxhinier Topograf, 1(një) inxhinier Hidroteknik, 1(një) inxhinier Mjedisi”, pasi operatori ekonomik “SMO Vataksi” për inxhinierin elektrik Shazie Hoti nuk ka paraqitur diplomë dhe Librezë Pune; operatori ekonomik “SMO Unioni” për inxhinierin elektrik Shazie Hoti nuk ka paraqitur Librezë Pune; Operatori ekonomik “SMO Unioni” për inxhinierin topograf nuk ka paraqitur Librezë Pune; Operatori ekonomik “SMO Unioni” për inxhinierin e mjedisit nuk ka paraqitur Librezë Pune.*

- Operatori ekonomik “SMO Vataksi” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”,* pasi për Inxhinierin Topograf dhe Inxhinierin Hidroteknik ka paraqitur fotokopje të Diplomës, të pa noterizuar.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët: 1 (një) punonjës elektrikist, 1 (një) punonjës teknik ndërtimi, 1(një) punonjës pllakashtrues”,* pasi operatori ekonomik “SMO Vataksi” për inxhinierin elektrik Shazie Hoti nuk ka paraqitur diplomë dhe Librezë Pune; operatori ekonomik “SMO Vataksi” për pllakashtruesin, elektrikistin dhe teknikun e ndërtimit nuk ka paraqitur kontratë pune.
- Operatori ekonomik “SMO Vataksi” nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)”,* pasi ka paraqitur Autobot uji të montuar, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton kamion i certifikuar nga Bashkia Shkodër për transport mallrash brenda vendit.
- Operatori ekonomik “SMO Vataksi” nuk plotëson pikën 15.e të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”,* pasi për mjetin fadromë me goma nuk ka paraqitur foto.
- Operatori ekonomik “SMO Union” nuk plotëson pikën 15.b të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)”,* pasi për mjetin Autobitumatrice të marrë me qera nuk ka paraqitur Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshme.

## **2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Eprofat V-50” shpk & “Bahas” shpk**

**NUIS K81714011L NUIS J61827083D**

- Operatori ekonomik “Eprofat V-50” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të*

*dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”, pasi për Mjekun ka paraqitur Diplomën dhe Urdhërin e Mjekut fotokopje të panoterizuar.*

- *Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Eprofat V-50” shpk & “Bahas” shpk nuk plotëson pikën 15.a të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes”, pasi operatori ekonomik “Eprofat-V 50” shpk ka deklaruar mjetin motosprucator bitumi (Bitumatrice) vetëm me faturë tatimore dhe operatori ekonomik “Bahas” shpk ka deklaruar bitumatrice të marrë me qera, pra nuk është paraqitur dokumentacion sipas kriterit të sipërcituar për mjetin Autobitumatrice. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Eprofat V-50” shpk & “Bahas” shpk nuk plotëson pikën 15.b të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)”, pasi për mjetin Autobitumatrice nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash të rrezikshme.*

### **3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk**

NUIS J67902718S

- *Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)”, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 9.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Alba Konstruksion” shpk**, me adresë: **Adresa: Rr. Frederik Shiroka, pallati I i ri, shkalla C, Tiranë** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **44,466,240** (dyzetë e katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 21.08.2017**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.